
Rruga e vjetër

Makina rrokulliset kurrizit të malit, veshur me hijen e qiellit. Rruga kërcet. Shoferi ndërron orë e çast marshet.

- Të mos qenë të katra gomat aktive, zor se mbërrinim, - thotë i mërzitur.

Heisi pothuaj nuk e dëgjon.

Si kalorësi që i lëshon frerin kalit, këmbët e çojnë përpara shtëpisë së vjetër. Mezi e njeh. I duket më e vogël, e mpakur, e tkurrur... Prag dita ndalon, ndërpret frymëmarrjen. Heshtja fryhet, trashet.

Koha kthehet mbrapsht...

Përmes gjelbërimit cerguar me plisa e baltë, si në rënie të ngadaltë shfaqet fëmijëria zhytur në bukuri dhe trishtim. Arra e vjetër, tani vjetruar edhe më, e shpërfill hapur. Mbi trungun e pjerrët, mijëra herë pati qëruar frutat e pabëra me gishtërinjtë e nxirë prej çaçanikut. Fërkon lëvoren e trashë të çarë gjithandej. Duart i dridhen.

“ Sa qenke plakur!”, - mërmërit.

Diçka e ujshme i ngjitet nëpër trup, e pengon të marrë frymë.

Një palë sy bojë gruri shfaqen papritur, vërtiten rreth trungut. Stërmundohet t'i kapë, ata i largohen. Kur kujton se i ka pranë, regëtojnë në vend tjetër. Trungu betër i gjerë i fsheh me hijen e vet të përjetshme.

“ - Paske ardhur?” - zëri vjen si jehonë e zbehur nga largësia.

Hap sytë, kthen kokën nga të katër anët.

“ - U vonove shumë...”

Tingulli del nga zgavra e nxirë në fund të trungut. Një lëng i zi katran kullon me zhurmë monotone. Tak... tak... tak...

“ - Afrohu! Sa më ka marrë malli!” - i lutet.

“ - S'më lë dielli, - psherëtin vajza e ngarkuar me pikëllim, - dhjetë vjet që më largon...”.

Dhimbja rritet, mahiset. Barra e kujtimeve bëhet e rëndë...

Mezi shtyn këmbët.

Porta e vjetër sa s'thuhet me fjalë e pret si gojë e hapur. Dhoma e thjeshtë ku lëshoi të qarat e para, shtëpia e rinisë, e ëndrrave përvëluese e shikon me miqësinë që me kohë ka zënë e ftohet. Shkallët, dy dhomat e sipërme, parrakët e ballkonit, korridoret, dheu i ngjeshur... Nuk janë fryt i imagjinatës. S'ka se si. Diçka reale qëndron pezull njëlloj si vite më parë.

Çdo gjë kaq e lashtë dhe e afërt njëherësh...

Ndien aromën e prindërve, të njelmët, të dashur e të pangjashme me asnjë tjetër. Tataja mbledh flokët e dendur ngjyrë floriri, lidh shaminë mënjanë, përvesh mëngët.

Në fytyrën bardhoshe ndrisin bula djerse. Lëviz me mashë saçin e rrjepur vende- vende, i hedh prush nga zjarri i oxhakut. Kacia copë-copë mezi mban nja dy thëngjij.

Përmes oxhakut, në çengelin e zi e të rëndë, rri varur kusia e nxirë nga përdorimi i gjatë.

“Kusia e xha Demes, - thotë ajo, - e Korçës ishte më e madhe, ia dhashë çupës në Tiranë. Ç’e do, e hodhi dosa!”.

Xhaxhai vjen rrugës së pusit, nga ana e sipërme e shtëpisë. I bie shkurt. I drejtë, i thatë e i mprehtë, thua ka më shumë kocka se mish! Hapi i shkathët prej djalë të ri. Kali prin përpara i djersitur, qimet e vitheve kullojnë. Mbi stivën e druve, një deng bari me lule të verdha prej Serdillëkut ndrin nga pastërtia.

Në mes të lëmit ndalojnë të dy.

“ - Selo, moj!” - gjëmon zëri i njohur

Tataja del me të shpejtë, rregullon në ecje e sipër shaminë rrëzuar mbi vetull. Në fytyrë i rrëzëllen ajo nënqeshja e butë që ia gropëzon faqet. Sytë kaltëroshë i vërvit dinakërisht mbi profilin burrëror.

Mban anën e druve. Zgjidhin litarët, barra rrëzohet me zhurmë të thatë.

“ - Ku është djali?”.

“ - Ja, dëgjoje!”.

Ai i ka futur pipëzën glyrës së arrës, buçet me të madhe. Në ajrin e kristaltë të mbrëmjes tingujt fluturojnë si në balada.

Burri qesh ngadalë nën zë.

“ - Thuaji të vijë!”...

- Po tani ku jeni, të dashurit e mi? Mos vallë të lodhur nga tërë ato punë, preheni këtej rrotull?

Kthen kokën, mban vesh... Dëgjon zhurmën e sëpatës që çan dru, fëshfëritjen e përbaltur të fustanit nëpër kopshtin e vaditur...

Tataja përkulet, këput misra të butë.

“ - Vëri në prush të përcëllohen!” - i hedh sytë kalimthi, thua e ka pranë çdo ditë.

I mbetet hatri, kërkon t’i afrohet ta përqafojë. Seç e pengon, një si perde e qelqtë, e rëndë... Mblidhet nga e keqja. Hidhërimi e mposht.

- Khë, khë...

Zëri i ngjirur e sjell në vete.

“- Nga duhani”, - i kujtohet në çast.

Turpërohet, nxjerr fshehura shaminë të fshijë lotët.

I ati as e ka mendjen, i përcjell vështrimin e atëhershëm sikur sapo janë ndarë. Ulet në stolin para portës, zgjat këmbët, mbështet kurrizin pas murit. I lodhur. Ka pasur ditë të ngarkuar. Heq kapelën, kruan kokën për forcë zakoni, e ngjesh përsëri. Nxjerr takëmet e duhanit, dredh cigaren. Me një të goditur ndez eshkën.

Era e gërxhallit i shpon hundët. Vë duart përpara gojës, kollitet mbytur.

Atij nuk i shpëton asgjë.

“ - Ama burrë i thua vetes!” - qesh me shpirt.
Tingëllimat e zërit gazmor zgjaten e zgjaten...
... Mbrëmja e verës venitet ngadalë, rruga malore spërdridhet dhe lahet në dritën e
mjerimit të vet. Kujtimet e Heis Brianit lundrojnë në erë si betim...

Nga romani “Pretenca”, ribotim 2017
